

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" ALBANIA TEKSTIL GROUP" SHPK



Sot me daten 24.01.2013 (njezet e kater Janar dymije e trembedhjetë), ditën e Enjte, ne ortaket themelues:

1.ILIR BASHO, i biri i Servet dhe i Drita, i datelindjes 25.08.1966, lindur ne Çepan, Skrapar dhe banues ne Lagja nr.3, Rr."Egnatia", Durres, i pajisur me Leternjoftim nr.029171211.

2.EDMIR BAKALLI, i biri i Ismail dhe i Sherife, i datelindjes 04.03.1979, lindur ne Sukth, Durres dhe banues ne Lagja Erzen, Sukth, Durres, i pajisur me Leternjoftim nr.027296191.

Ne perputhje me Ligjin nr.9901 Date 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kemi vendosur te themelojme **Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar**

« ALBANIA TEKSTIL GROUP» SHPK

NENI 1.

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet « **ALBANIA TEKSTIL GROUP** » SHPK.

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Lagja nr.14, Shkozet, Rruga "Kavaja", mbrapa Institutit te Bimeve.

Shoqeria mund te krijojë filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

1.Tregtim me shumice dhe pakice te tekstileve te llojeve ndryshme, import-eksport te tyre.

2.Tregtim me shumice dhe pakice te amballazheve te llojeve te ndryshme, import-eksport te tyre.

3.Tregtim me shumice dhe pakice dhe import eksport te: Veshmbathje dhe konfeksione te ndryshme, hidrosanitare, hidraulike, kancelari per zyra dhe shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike kompjuterike, kinkaleri, produkte bujqesore dhe blegtorale, fruta perime, produkte deti, prodhime kozmetike, parfumeri kimike dhe detergjenteve.

4.Mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije alkolike dhe jo alkolike.

NENI 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise « **ALBANIA TEKSTIL GROUP** » SHPK eshte 100.000 (njehindemije) leke.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 kuota, sejcila me vlere nominale 1.000 (njemije) leke.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

1. ILIR BASHO, zoteron **49% kuota baraz me 49 % te kapitalit.**

2.EDMIR BAKALLI, zoteron **51 % kuota baraz me 51 % te kapitalit.**

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrator i shoqerise « **ALBANIA TEKSTIL GROUP** » SHPK do te jete **Z.ILIR BASHO**, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripërteritje te ketij afati.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakeve, qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Administratori gezon kompetencat e parashikuara ne nenin 95/3 te ligjit dhe kompetenca te tjera te parashikuara ne nene te posacme te ketij ligji.


Administratori ka te gjithë kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve. Administratori mund te kryej te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 7

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE

1.Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar ,te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj , operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregtar shqiptar.

NENI 10

MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.Ne rast te kundert, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykates Rrethit per zgjidhje.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

" ALBANIA TEKSTIL GROUP" SHPK

1. ILIR BASHO



2. EDMIR BAKALLI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES

NR. 395 REP.

NR. 139 KOL.

Durres, me 24.01.2013



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Durres, sot me date 24.01.2013 (njezet e kater Janar dymije e trembedhjetje), ditën e Enjte, në zyrën e noterisë të ndodhur në Lagja nr.2, Rruga "A.Goga", Durres, përpara meje noteres Flutura Abdiu, Anetare e Dhomes së Noterisë Durres, u paraqiten personalisht shtetasit e mëposhtem :

1.ILIR BASHO, i biri i Servet dhe i Drita, i datelindjes 25.08.1966, lindur në Çepan, Skrapar dhe banues në Lagja nr.3, Rr."Egnatia", Durres, i identifikuar nga Letërnjoftimi nr.029171211.

2.EDMIR BAKALLI, i biri i Ismail dhe i Sherife, i datelindjes 04.03.1979, lindur në Sukth, Durres dhe banues në Lagja Erzen, Sukth, Durres, i identifikuar nga Letërnjoftimi nr.027296191,

Madhor e me zotesi të plote juridike për të vepruar, të cilet me dëshirë të plote dhe vullnet të lirë, nënshkruan në prezencën time, personalisht: **AKTIN E THEMELIMIT TË SHOQERISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR "ALBANIA TEKSTIL GROUP" SHPK**, bashkangjitur këtij vertetimi nënshkrimi.

Une noterja Flutura Abdiu në bazë të ligjit nr.7829 date 01.06.1994 "Për Noterine", e vertetoj rregullisht sipas ligjit.



NOTERE
FLUTURA ABDIU



Basho
Ilir
Shiptari/Albanian
Cesia, Skrapar
25-08-1986
17-06-2010
MB

029171211

16-06-2020
G60825067G



Bakalli
Edmir
Shiptari/Albanian
Sukth, Durrës
04-03-1979
17-08-2009
MB

027296191

16-08-2019
H90304168T



I<ALB0272961915H90304168T<<<<<
7903041M1908169ALB<<<<<<<<<<<5
BAKALLI<<EDMIR<<<<<<<<<<<<<<<<<

I<ALB0291712112G60825067G<<<<<
6608257M2006165ALB<<<<<<<<<<<8
BASHO<<ILIR<<<<<<<<<<<<<<<<<